



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0017523-2/ dt. 27.03.2021
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 pika (f) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 15 të Ligjit Nr.08/L-245 për Artin dhe Kulturën, si dhe Propozim - Vendimin Nr. 01-020/04-0017523/25, dt. 24.03.2025, nga z. Sabit Sheremeti Ud. Drejtor i Teatrit të Qytetit, për formimin e Këshillit Artistik të Teatrit të Qytetit “Muharrem Qena”, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për formimin e Këshillit Artistik të Teatrit të Qytetit “Muharrem Qena”)

1. Formohet Këshilli Artistik i Teatrit të Qytetit “Muharrem Qena”, në këtë përbërje:

1.1 Fisnik Ademi – anëtar (aktor rezident i Teatrit) propozuar nga Kryetari i Komunës;

1.2 Marigona Bekteshi – anëtare (Drejtoreshë e Artit teatral dhe Shkencave teatrale) propozuar nga Ud. Drejtori i Teatrit të Qytetit;

1.3 Lulzim Hakaj – anëtar propozuar nga Komuniteti artistik lokal.

2. Këshilli Artistik i Komunës do të ketë rol këshillues për drejtorin dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi: këshillon drejtorin në hartimin e programit artistik dhe mbështet drejtorin në realizimin e programit artistik.

3. Këshilli i lartcekur bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr.08/L-245 për Artin dhe Kulturën, si dhe dispozitat ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

4. Këshilli i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat pesë (5) vjeçar.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA

Shtojcë:

Propozim-vendimi i DKRS-së, Nr. 01-020/04-0017523/25, dt. 24.03.2025, nga z. Sabit Sheremeti Ud. Drejtor i Teatrit të Qytetit.

T'i dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Anëtarëve të Këshillit
- 1x1 Arkivit